



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës
Nr.02/_____
Datë: 22.08.2019

23-08-2019
02/678

PROCESVERBAL

i mbledhjes së VI-të (gjashtë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së III dhe V të Kuvendit për vitin 2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/203 datë:28.03.2019 të parashtruar nga Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
3. Shqyrtimi i Raportit për kompensimin e tri pagave përcjellëse, sipas kërkesës së KPF-së dhe marrja e vendimit për kompensimin e tyre.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Planit të Integritetit të Komunës së Malishevës për vitin 2018-2020.
5. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi për mbjelljet pranverore për vitin 2019.
6. Shqyrtimi i kërkesës nr.05/225 datë:06.06.2019 për inicim të procedurave për hartimin e hartës zonale të Komunës.
7. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/303 datë:22.05.2019 e parashtruar nga Sindikata Komunale e Arsimit parauniversitar (SKAP) në Malishevë.
8. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/305 datë:23.05.2019 e parashtruar nga përfaqësuesi i shoqatës “SHËN TEREZA” dega në Malishevë.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/53 datë:17.05.2019 e parashtruar nga z.Rexhep S. Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/58 datë:27.05.2019 e parashtruar nga z.Arsim S.Krasniqi ngafshati Tërpezë e Poshtme, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
11. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 14.06.2019 dhe filloi në ora 10:39 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 20 asambleistë, Nënkryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, KDI, LMT dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! E hapi mbledhjen e VI-të të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Malishevës. Si çdo mbledhje e hapi debatin jashtë rendit të ditës.

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! Para pak ditës së bashku me Florentinën kemi kaluar si asambleistë të pavarur dhe sot të dy i bashkohemi grupit të AAK-së.

Rrahim Morina: Sipas Rregullores së Punës së Kuvendi më shumë se 2 veta mund ta formojnë një grup politikë këtu në Kuvend e kështu mund të vazhdojmë me procedurat e mëtejme.

Alban Krasniqi: Si procedurë Kastriot kjo duhet të bëhet në mënyrë të shkruar. Fatekeqsisht ka shumë çështje që meritojnë që të diskutohen këtu e një ndër to është çështja e punësimeve në K. e Malishevës. Tani është bërë e pamundur të hysh në punë nëse nuk ju nënshtrohesh NISMA apo Kryetarit Begaj. Kjo është forma më e ulëtë, anivlerë dhe më e poshtër e cila është duke ndodhur e që është gjetur edhe në raportin e auditorit siç është rasti i fundit i anulimit të konkurisit për stamotolog në Kjevë. Rasti i fundit është në Drejtorinë e Urbanizmit për Zyrtarin për Ndërtim e që është Ramiz Hoxha e që dy vjet aty është me kontratë mbi vepër e që ka pasur me më përgatije kundërkadidatët e tij. cili është ky mesazh që po e jepni? Kjo është është poshtërsi!

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Jemi afër manifestimit të Ditës së Çlirimit ët Malishevës dhe rënies së dështmorit të parë Imer Krasniqi dhe duhet që sot të flasim për organizimin e festës së 16 Qershorit dhe jo të lëshohemi në çështje tjera. Për ato që tha parafolësi im jam që të respektohet ligji dhe të përdorën të gjitha mekanizmar siç është Inspektoriat i Punës, prokuroia etj. ku për çdo keqpërdorim t'ju drejtoheni e ato ta kryejnë punën e vet. Meqenëse sancën e radhës e kemi solemnd dhe fjalën do ta ketë vetëm Kryetari dhe Kryesuesi i uroj të gjithë qytetarëve të Malishevës 20-vjetorin e çlirimit!

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Në takimet e bajtura në Drenoc dhe dje në Bellanicë me gra ato insistojnë që shërbimet shëndetësore të jenë në nivel. Ju e dini asambleistë që ne kemi votuar buxhetin për mamografinë, mirëpo po thuhet se nuk mund të investojmë aty sepse duhet të krijohet ambienti për të. Ne si gra kemi kërkuar në gjinokologji të investohet për ultrazërin që bëhet papa-testi sepse mjekët i kemi për këtë. Kërkoj që këtë çështje Nënkryetar ta merrni seriozisht sepse është zëri grave dhe është e rëndësishme për shëndetin e tyre. Në rruga “William Voker” gypi kryesor i ujit që shkon për Carrallukë shpërthen shpesh që 2-3 vjet leje që ka shkatërruar asfaltin por po derdhet edhe uji i pijëshëm sepse aty është krijuar si pus. Ne kemi mungesë të ujit të pishëm në sezonën e verës ndërsa aty uji po derdhet dhe Hidroregjioni nuk po merrë asnjë masë.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Pasi që jemi afër 20-vjetorit të ditës së Çlirimit të Malishevës në emër të të dy komiteteve dhe të tri kategorive të dalura nga lufta edhe pas dy herva të drejtuar me shkrim Kryetarit të Komunës për ndarjen e një parcele për ndërtimin e zyrave për kategoritë e dalura nga lufta kërkoj edhe sot. Deri sot unë s'kam marrur asnjë përgjigjie për këtë çështje dhe do të kërkoj këtë çdo mbledhje deri sa ta miratoni këtë kërkesë sepse kur të flasim për vlerat është mirë që t'u plotësojmë disa kushte.

Raimonda Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Po e nis fjalimin me një urim për Halil Brahaj ish-drejtorin e shkollës fillore së Senikut për fitoren ndaj padrejtësive dhe shkeljeve të vazhdueshme që ka bërë pushteti NISMA sidomos në sektorin e arsimit. Me 31 maj të v. 2019, Halil Brahaj nga fshati Senik i cili ka qenë drejtor i shkollës “Gjergj Fishta” në Senik i është dhënë e drejta për vendin e punës sepse ka qenë legjitim në këtë detyrë dhe ka marrë dëmshpërblim në vlerë prej 9,000€. Uroj tani e tutje të mos ketë shkelje të tilla sepse po dëmtohet paraja publike e qytetarëve tanë!

Nënkryetari mori për detyrë që të intersohet dhe t’na përgjigjet për paqartësitë, parregullsitë në përfitimin e OJQ-ve dhe personave publikë të cilët kanë konkuruar për vitin 2019. Prej mbledhjes së kaluar përveç kërkesës që e kemi paraqitur këtu, ne e kemi bërë kërkesë edhe për Kryetarin e Komunës si dhe drejtoreshës së Kulturës me nr. të protokollit 01/685 me dt. 22.05.2019. Ne nuk kemi marr asnjë përgjigje edhe pse janë bërë 22 ditë nga data e protokolluar e kësaj kërkeje. A ka përgjegjësi për këtë çështje, apo jo? Nëse jo do të presim edhe 7 ditë deri sa të bëhet 1 muaj sipas afatit ligjor dhe do t’i drejtohem MAPL-së dhe gjykatës.

Çështja e tretë. Urime për banorët e Tërpezës të disa lagjeve që u është asfaltuar rruga e që po i reklamojnë nëpër faqe publike ekzekutivi i Malishevës sepse ato rrugë janë shtruar në tetor të vitit 2018 e tani ka birë bari aty në asfalt. Me foto po ju dëshmojë. Gjithaashtu është bërë diskriminim ndaj qytetarëve duke ua shtruar rrugën vetëm për një familje të vetme dhe duke i lënë anash 2-3 rrugë të rëndësishme që kanë 10-15 familje. Diskriminimi, nënçmimi, përbuzja por edhe presioni për t’i detyruar ata dhe për t’i nënshtruar ata që të kthehen me NISMA dhe duke bërë pazare politike.

Nebih Bibaj: Perhsendetje për të gjithë! Nënkryetar, për të hyrë në punë pajtohem me Albanin sepse pa e pas librezën e partistë s’ka punë.

Nënkryetar sigurimi që po rri para Kuvendit, a kanë të drejtë në kompenzimin e kujdestarisë, nëse kanë të drejtë pse nuk po kompenzohen? Sigurisht që ju do të arsyetoheni që nuk keni buxhet, por a ka buxhet që i keni punësuar 40-50 me kontratë mbi vepër?

Problemi tjetër është mungesa e ujit të pijshëm në Carrallukë, Lladroc, Shkozë etj. ne e dimë se sa pusi është hapur në Lladroc dhe prap nuk ka ujë të pishëm, ndërroni pompën bëj diçka për qytetarët. Nënkryetar, gypi kryesor pse nuk ka vazhduar deri në fund të fshatit por është ndalur te ura e fshatit Lladroc?

Alban Mazreku: Pershëndetje për të gjithë! Paraprakisht po ju uroj Ditën e Çlirimit të Malishevës gjithë qytetarëve, familjeve të dëshmorëve dhe gjithë atyre që kontribuan për lirinë e vendit!

Sa herë që do të mbahen mbledhje do ta flas për këtë çështje për mbylljen e një kanali në rrugë në hyrje të Malishevës nga Banja dhe aty është krijuar një moqal i vogël dhe çdo ditë ka aksidente. Është mirë që të intervenohet aty.

Nënkryetar, lagjia jonë e ka bërë një kërkesë për vendosjen e policëve të shtrirë në rrugën “Gjergj Kastrioti” sepse për shkak të shpejtësisë së madhe të makinave po rrezikohet jeta e qytetarëve.

Përrreth ndërtesës së komunës dhe ndërtesës së “Dardanisë” po ka shumë mbeturina dhe për shkak të temperaturave të larta mund të ketë edhe ndonjë lloj epidemie. Kërkoj nga organet kompetente që të merren masa për çështjet që po i debatojmë këtu e të mos mbesin veç fjalë.

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Të gjithë qytetarëve të Malishevës i uroj Ditën e Çlirimit dhe shpresoj që jemi në rrugën e atyre që të jetojmë e të punojmë të lirë!

Dua t'i ngriti dy çështje. E para ka të bëjë me bizneset private që për punëtorët që punojnë nëpër këto biznese është mirë që ta caktojmë një ditë pushimi mbrenda javës sepse në 7 ditë javës nuk kanë asnjë ditë pushimi. Për këtë është mirë që të nxjerrim një vendim për këtë çështje.

Çështja tjetër ka të bëjë me publikimin e bursave është mirë që të shikohet a është përfillur rregullorja.

Hajdin Berisha: Pershendetje për të gjithë të pranishmit këtu! Edhe unë si gjithë parafolësit po ua uroj Ditën e Çlirimit të Malishevës dhe urimet do t'i përcjellim edhe përmes aktiviteteve që ne kemi organizuar për këtë ditë.

Këtu u përmend anulimi i konkursit për stomatolog. Çdo rekomandim që vjen nga institucionet përgjegjëse ne jemi të obliguar që ta zbatojmë. Ku është gabimi procedural që është bërë me këtë konkurs inspektoriati e ka vë në pah dhe gjërat e tilla do të përmirësohen.

Sa i përketë punësimit të Ramiz Hoxhës në Drejtorinë e Urbanizmit konsideroj që ai është meritori dhe mendoj që procedurat e konkursit kanë qenë të rregullta.

Profesoreshë, ne vazhdimisht përpiqemi që shërbimet shëndetsore me qenë në nivelin e duhur në vitin 2016 pas shumë kërkesave dhe ististimeve kam arritur që të sjell aparatën mobil të mamografisë në Malishevë për 2 muaj dhe për të pasur një aparat mamografie këtu ne e kemi diskutuar këtë edhe te hartimi i buxhetit.

Ilaz, ne jemi duke u marrur seriozisht për çështjen e zyreve për organizatat e dalura nga lufta dhe për t'ju siguruar një ambient më komod për to.

Sa i përketë ujësjellësit ne kemi probleme me Hidroregjionin, ka shpërthim të gypave, e prishin asfaltin, trotuarin e komuna madej gjithëmonë duhet të merret me puntë e tyre. Që ka mungesë kaq të madhe të ujit ne nuk i kishim informacione. Besoj ne dhe komapnia do ti marrim për bazë këto shqetësime.

Rrahim Morina: Falemnderit Nënkryetar! Kalojmë në debatin për rendin e ditës të cilin e keni marrur mirë vonesë dhe ju kërkoj falje. Ne me kohë e kemi përgatitur materialin por faji është te ekzekutivi i cili shpërndarjen e ka bërë me vonesë.

Ne e kemi një kërkesë nga Kryetari i Komunës nr. 01/835 e dt. 14.06.2019 nga Kryetari i Komunës së Malishevës dhe i Këshillit Organizativ Ragip Begaj për Kuvendin Komunal të Malishevës për oraganizimin e ndarjeve të mirënjohjeve konformë Statutit të Komunës të Malishevës për rastine Ditës së Çlirimit të Malishevës.

E hapi debatin për rendin e ditës.

Arbreshë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ne jemi në jubeleun e festës për Ditën e Çlirimit dhe ne duhet që të kontribojmë e ta bëjmë sa më madheshore këtë festë ne ndihemi mirë që sot do të debatojmë për këtë çështje.

Valon Krasniqi: Pershendetje! Grupi ynë kërkon që anëtarin nga LDK-jai Komitetit për Bujqësi të zëvendsohet me një tjetër dhe kërkojmë që të futet si pikë në rendin e ditës.

Rrahim Morina: Valon, bëjeni si grup një kërkesë me shkrim protokollojeni dhe mbetet që të futet për mbledhjen e ardhshme si pikë.

Kastriot Berisha: Dita e Çlirimit është ditë e veçantë për të gjithë ne dhe Kërkesa e Kryetarit për ndarjen e çmimeve kërkoj që në këtë vit mos të politizohen por të merret një vendim dhe t'u jepet përgjegjësia organeve përgjegjëse siç janë organizatat e dalura nga lufta, sindikatat e ndryshme për ndarjen e çmimeve.

Ne jemi pro rendit të ditës.

Avdi Morina: Meqenëse jemi afër Ditës së Çlirimit dhe unë ju uroj të gjithë qytetarëve të Malishevës këtë festë!

Kryesues propozoj që kërkesa e Kryetarit për ndarjen e çmimeve dhe mirënjohjeve të hyjë si pika e parë në rendin e ditës pas procesverbalit.

Rrahim Morina: Meqenëse s'ka diskutues të tjerë kemi veç një propozim nga Avdiu që kërkesa e Kryetarit të renditet si pika e dytë në rendin e ditës pas procesverbalit. Kush është pro këtij propozimi?

Për: unanimit

Atëherë shkojmë në votim për rendin e ditës. Kush është pro miratimit të rendit të ditës me plotësime dhe në tërësi?

Për: unanimit

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së III dhe V të Kuvendit për vitin 2019. E hapi debatin.

Hidajete Mazreku: Edhe në mbledhjen e kaluar e kam ngritur çështjen e shëndetësisë primare ku kam thënë që investimet kapitale kanë qenë të planifikuara 514,000€, mirëpo për 3-kujorin e parë janë shpenzuar 492,000€ dhe për këtë kam kërkuar sqarim nga drejtori i Financave. Sekratisë u është përvjedhur kjo dhe e ka humb kutimin ajo fjali prandaj doja ta sqaroja këtë.

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutues të tjerë, kush është për aprovimin e procesverbaleve III dhe V të vitit 2019?

Për: unanimit (23)

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nga Kryetari i Komunës nr. 01/835 e dt. 14.06.2019 nga Kryetari i Komunës së Malishevës dhe i Këshillit Organizativ Ragip Begaj. Propozoj që të shkojmë vetëm në votim sepse propozimet i kemi e të mos lëshohemi në debate sepse të gjithë janë njerëz meritë. Para se me hap debatin është mirë që Nënkryetari t'na informoj në pika të shkurtëra se si ka shkuar puna në këtë Këshill.

Hajdin Berisha: E kam kryesuar Këshillin Organizativ në cilësinë e kryesuesit dhe i famlemnderoj të gjithë anëtarët nga subjektet politike që kanë qenë pjesë e këtij Këshilli sepse secili në formën e vet e ka dhënë kontributin e tij.

Fillimisht ne u patëm dakorduar për formatin dhe emblemen e e ftesës, listën e të ftuarve dhe shumë gjëra tjera që kjo festë të jetë sa më dinjitoze.

Për çmimin për Trimëri dhe Heroizëm "Imer Krasniqi", Këshilli Organizativ sjellë në Kuvend propozimet e Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së.

1. Metush Kryeziu nga fshati Bubavec, veteranë nga brigada 122 "Imer Krasniqi"

2. Muhamet Begaj nga fshati Banjë veteranë nga brigada 121 "Ismet Jashari - Kumanova"

Propozimi i 3-të është nga Kryesuesi për Fetah Rudin nga fshati Rud

Për çmimin "Hamdi Berisha" që jepet për arsim janë propozuar:

1. Hanife Gashi nga fshati Kijevë
2. Ismet Mazreku nga Malisheva

Për çmimin “Dr. Shëtim Robaj” për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë janë propozuar:

1. Dr. Naim Kryeziu nga fshati Bubavec
2. Ragip Morina teknik medicinal nga fshati Astrazup

Këto janë rekomandimet që janë ardhur nga Këshilli Organizativ, materialin e keni marr dhe ju ftoj që të bëni debat konstruktiv dhe si Asamble të dalim sa më serioz për këtë festë.

Rrahim Morina: Për procesbajtësin e këtij Këshilli them që nuk është dashur që ta bëjë renditjen në këtë formë në procesverbal, por është dashur të shënohet Nënkryetari, Kryesuesi, pastaj ata që kanë pasur të drejtë vote dhe pjesa tjetër si pjesëmarrës por pa të drejtë vote. Kjo është mirë që të bëhet kështu për herat tjera. E hapi debatin për këtë pikë.

Luan Kryeziu: Sa i përket kësaj pike kur propozohen emrat për këtë çmime që ndanë K. e Malishevës e sidomos për heroizëm është mirë që të shkohet mbi bazën e meritokracisë dhe të radhitën në bazë të meritave që kanë dhënë në UÇK e të mos bajmë selektime në bazën partiake. Çdo herë kur të bëhet vlerësimi siç është në këtë rast në bazë të meritave sepse sipas këtij procesverbali më së shumti paska shkuar propozimet në bazën politike po në bazë të kontributit dhe meritave sepse dimë që pas 20 viteve luftë ka njerëz me plagë në trup.

Kastriot Berisha: E thash edhe më heret që në disa pika të ndjeshme është mirë që të merremi vesh paraprakisht që mos të viem deri te heqja e dikujt. Propozoj që sot të marrim një vendim dhe t’ju lëmë organeve përgjegjëse që të merren me këto sepse ne nuk jemi disa në mosh që t’i vlerëojmë për kontributin e dhënë, por vendimin për ndarjen e çmimeve ta marrim shoqiatat e dalura nga lufta, sindikatat e ndryshme të shëndetësisë dhe arsimit etj.

Në emër të grupit të AAK-së dhe në emrin tim propozoj që për çmimin “Hamdi Berisha” të hyjë në listë edhe Hasan Zogaj, ndërsa për çmimin “Dr. Shpëtim Robaj” të hyjë në listë Dr. Mexhid Toplana.

Hajdin Berisha: Këshilli Organizativ i ka shqyrtuar propozimet që kanë ardhur nga faktorë të ndryshëm. Ka pasur propozime që janë ardhur nga QKMF-ja në Malishevë, nga Sindikata e Pavarur e Arsimit si dhe propozimet për çmimin për “Trimëri dhe Heroizëm” i kemi pasur nga Shoqata e Veteranëve të UÇK-së dhe ne i kemi analizuar dhe shqyrtuar këto propozime e kemi ardhur me këtë listë këtu.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Po e përforcoj fjalën e Nënkryetarit se propozimet kanë ardhur nga sindikatat, Drejtoria e Arsimit dhe Këshilli Organizativ i ka votuar secilin një nga një ose me koncesius përjashtimisht që konsensus nuk ka pasur për çmimin për “Trimëri dhe Heroizëm” që ka ardhur nga Shoqata e Veteranëve të luftës së UÇK-së.

Kryesues, portali i NISMA Malisheva.net thotë që PDK-ja del kundër OVL-së. Kjo nuk është e vërtetë sepse më shumë se PDK-ja askush nuk i mbronë interesat dhe vlerat e UÇK-së kërkoj që mos të shpëj në këtë drejtim sepse do të ballafaqohen me gjykatë.

Kryesues në fund të debatit për këtë pikë kërkoj 5 min pauzë para votimit.

Rrahim Morina: Për dy çmimet për arsim dhe shëndetësi ka qenë koncesiusi i plotë vetëm për çmimin për “Trimëri dhe Heroizëm” propozimet janë hedhur në votim.

Alban Krasniqi: Kur flitet për çështje të rëndësishme ku vlerat duhet të çmohen dhe kjo duhet të shihet në rrjedhën e procesit. Neve na ka ardhur procesverbali i Këshillit Organizativ, por neve na është dashur ecuria. Vlerësimi më i madh për të propozuarit do të ishte sikur Këshilli të kishte CV-të e personave të nominuar t'na vie përpara. Thjeshtë po ndjehem keq kur po merren këso vendime. A ka mundësi se kur flasim për propozime të fushave të tilla, të njerzëve përkatës të jetë biografia e tyre sepse ashtu i respektojmë shumë e më shumë ata.

Axhenda është shumë e mangët me aktivitetet për këtë festë jubilarë. Kam kërkuar edhe një parakalim të strukturave para masave, por nuk ka gaditshmëri përveç që po japin darka e dreka.

Kam pritur një zemërgjersi më të madhe nga shoqatat e dalura nga lufat sa i përket propozimeve edhe pse për ata dy vlerësimi është maksimal mirëpo për pozitat që kanë dhe funksionet që janë duke ushtruar kanë mundur të përbihen pak e mas pak viteve mund të merrnin këtë çmim. Meqenëse ka qenë këmbngulje e disa kolegëve bashkëluftetarë me gjithë kritikën tona edhe ne duhet t'i përkrahim. Edhe propozimet tjerë janë në rregull dhe janë njerëz meritore. Një ndër këto propozime po e përmend edhe një emër të merituar të arsimit post-mortum mësuesën time Fatmire Bogiqi e cila ka vdekur nga një smundje në kushte të rënda. Kam emocione kur flas për të. Ajo ka ardhë mësuese nga Drenasi kur kanë qenë vetëm dy mësuese në Malishevë dhe ka udhëtuar në kushte të rënda. E pse s'ja përmend emrin askush asaj, pse s'ka krah a? A e dini sa mësues, ushtarë e veteranë, invalidë i kemi pa krah sote që jetojnë në fukrallakë e ne nuk i kemi emrat e tyre në listën e çmimeve?!

Ne si grup jemi për propozimet që na janë sjellë këtu dhe kërkoj mirëkuptim e juaj që këta emra të ecin përpara e ta festojmë këtë ditë ashtu siç i ka hije.

Valon Krasniqi: Kam një kërkesë në formë të lutjes për të gjithë kolegët që të gjithë të propozuarit janë personazhe me vlerë atëherë ne duhet që të përmbahemi e të mos i etiketojmë në formë të ndryshme sepse të gjithë kanë kontribuar për këtë vend!

Hajdin Berisha: Veteranët janë duke shkuar në moshë dhe një prej tyre që e ka ngritur këtë çështje është Albani do të duhet që në të ardhmen të mendoj Asambleja se pse me qenë striktë veç dy. Duhet të mendohet se si të gjenden modalitete për më shumë ndarje të çmimeve për veteranë sepse e meritojnë para se të shkojnë në botën tjetër ashtu siç e përmendi Albani mësuesën e tij.

Agjenta nuk është e varfër Alban, le të realizohen me pikëmburi ato aktivitete të cilat janë paraparë në ftesë do të del një festim dinjitoz i Ditës së Çlirimit të Malishevës.

Arbëreshë Krasniqi: Jemi në një ditë aq sa të rëndësishme ashtu edhe të vlerës dhe secili prej nesh në një formë i kemi përjetuar vështirësitë, mundimin nëpër të cilën ka kaluar Kosova gjatë luftës dhe pas saj. Megjithatë jemi të gjithë të vlerësuar njëjtë që lufta e UÇK-së është një ndër luftërat më të lavdishme e popullit të Kosovës dhe kjo na bënë që të ndjehmi krenarë dhe aq më shumë krenohemi që sot si asambleistë vlerësojmë mundin dhe sakrificën e tyre ndajmë çmime për kontributin e dhënë në kohët më të vështira në Kosovë në çdo fushë.

Jemi në tri situata ku ndahet çmimi për Trimëri dhe Hëroizëm "Imer Krasniqi", çmimi për kontributin e dhënë në fushën e arsimit "Hamdi Berisha" dhe çmimi për kontributin e dhënë në shëndetësi "Dr. Shpëtim Robaj". Të gjithë këta që nderohen me këto çmime nderohen me emrat më të mndhenjë të luftës së Kosovës.

Ne si grup pajtohemi me të gjitha propozimet që vijnë si rezultat i shoqatiave të dalura nga lufta, të mirëfillen dhe të trajtohen me vlerë. Pajtohem me atë tha Albani për CV-ën e çdo të propozuari për çmim sepse kemi me çka të mburremi.

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutues më shkojmë në pauzë që kërkoj PDK-ja.

Gjatë kësaj pauze nuk mundem të gjejmë koncesiuës atëherë do t'i hedhim në votim një nga një të gjithë të propozuarit për ndarjen e këtyre çmimve.

Çmimi për trimëri dhe heroizëm "Imer Krasniqi" të propozuar nga Këshilli Organizativ janë:

1. Metush Kryeziu nga fshati Bubavec, veteran nga brigada 122
2. Muhamet Begaj nga fshati Banjë, veteran nga brigada 121
3. Fetah Rudi nga fshati Rud

I hedhi në votim emrat një nga një. Kush është pro që Metush Kryeziut t'i ndahet çmimi "Imer Krasniqi"?

Për: 25 (unanimisht)

Propozimi i dytë është Muhamet Begaj, kush është pro që t'i ndahet çmimi "Imer Krasniqi"?

Për: 16

Kundër: 7

Abstenim: 2

Tash Muharrem a duhet me hedh në votim edhe propozimin për Fetah Rudin a jo?

Muharrem Morina: Satuti këtë nuk e specifikon, por nga praktika që nga paslufta nga 2 çmime janë nda. Ju është dasht të vendosni më parë se sa çmime me i nda përveç këtyre 2.

Rrahim Morina: Muharremi po heziton të jep përgjigjie. E hedhim në votim edhe propozimin e 3-të. Kush është pro që Fetah Rudin t'i ndahet çmimi për trimëri dhe heroizëm "Imer Krasniqi"?

Për: 9

Kundër: 3

Abstenim: 8

Alban Krasniqi: Kryesues po e prish festën. Nuk ka çmim të tretë. Mos e sjellni Kuvendin në këtë gjendje.

Rrahim Morina: Unë kërkoja sqarim nga Muharremi, ai hezitoi të na jap përgjigjen e duhur, prandaj e hodha në votim edhe propozimin e 3-të. Në këtë rast dy propozimet e para fituan edhe në rregull është.

Kalojmë në propozimet për çmimin e dytë që ndahet për kontributin në fushën e arsimit "Hamdi Berisha" dhe të propozuar janë:

1. Hanife Gashi nga fshati Kjevë
2. Ismet Mazreku nga Malisheva
3. Hasan Zogaj nga Lladroci (i propozuar nga Kastriot Berisha)

Shkojmë në votim një nga një. Kush është pro që Hanife Gashit t'i ndahet çmimi "Hamdi Berisha" për kontributin e dhënë në arsim?

Për: 22

Kundër: 0

Abstenim: 3

Kalojmë te propozimi i dytë. Kush është pro që Ismet Mazrekut t'i ndahet çmimi "Hamdi Berisha" për kontributin e dhënë për shkollën shqipe?

Për: 13

Kundër: 8

Abstenim: 4

Me këtë votim kalon edhe ky propozim.

Shkojmë për ndarjen e çmimit të 3-të për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë "Dr. Shpëtim Robaj" dhe të propozuarit janë:

1. Naim Kryeziu nga fshati Bubavec
2. Ragip Morina nga fshati Astrazup
3. Mexhid Toplana nga fshati Kjevë (i propozuar nga Kastriot Berisha)

Kalojmë në votimin një nga një për të propozuarit. Kush është pro që Naim Kryeziut t'i ndahet çmimi "Dr. Shpëtim Robaj"?

Për: 24 (uanimisht)

I propozuari i 2-të është Ragip Morina për ndarjen e çmimit "Dr. Shpëtim Robaj" për kontributin e dhënë në shëndetësi, kush është pro?

Për: 14

Kundër: 10

Abstenim: 1

me këtë votim i ndahet edhe çmimi Ragip Morinës për kontributin e dhënë në shëndetësi. Të gjithë atyre që u ndanë çmime ju urojmë suksese dhe jetë të gjatë.

Hajdin Berisha: I falemndroj të gjithë anëtarët e Këshillit Organizativ dhe të gjithë asambleistët këtu për kontributin që dhanë për ndarjen e këtyre çmimeve!

Rrahim Morina: Shkojmë në pauzën e drekës, shihemi në ora 13:30!

Pas pauzës së drekës kontaktova me shefen e grupit të NISMA Arbreshën. Ajo tha që pas përfundimit të votimit të pikës së dytë për ndarjen e çmimeve ajo tha që kërkonte fjalën që mbase jem para festës mbledhja të përfundoj më atë pikë e pikat e tjera të rendit të ditës të barten për mbledhjen tjetër, prandaj edhe nuk janë më pjesë e vazhdimit të kësaj seance. Kourrum tani nuk kemi dhe konsideroj që mbledhja nuk mund të vazhdohet më dhe këto pika mbeten për mbledhjen tjetër.

Raimonda Krasniqi: Në fillim të mbledhjes kur u diskutua rendi i ditës kërkesë e asambleistëve të NISMA ishte që të futet në rendin e ditës kërkesa e Kryetarit për ndarjen e çmimeve për Ditën e Çlirimit të Malishevës dhe e kanë miratuar rendin e ditës në tërësi bashkarisht me neve duke futur edhe këtë pikë. Ndërsa kërkesa tjetër për mos vazhdimin e mbledhjes ka dalur më vonë dhe do t'ua tërhiqja vëretjen që mos t'na injorojnë në këtë mënyrë!

Alban Krasniqi: Edhe pse kourrumin nuk e kemi për votim ne mund të diskutojmë për piakat e rendit të ditës ndërsa në mbledhjen tjetër mund të marrim vendim. Këtë asgjë se pengon. Kryesues të ikën edhe 2 të partisë tane dhe kjo me të vërtetë është papërgjegjësi dhe është fyrrje për qytetarët kjo.

Kryesues ata që kanë munguar pa arsye në listën e pjesëmarrjes t'i bëni mungesë e t'ju ndalen menditjet se nuke di ç'është ky luks që të lëshohet mbledhja për pikë të qefit.

Alban Mazreku: I falemnderoj Bashkimin dhe Dibranin si dhe stafin e Kuvendit që po qëndrojnë këtu. Ekzekutivi vet e ka sjellë Planin e Intergritetit si pikë dhe vet nuk po qëndrojnë këtu.

Si pikë e 3-të e rendit të ditës ishte: Shqyrtimi i Raportit për kompensimin e tri pagave përcjellëse, sipas kërkesës së KPF-së dhe marrja e vendimit për kompensimin e tyre. Ne e dim që çdo ditë ka persona që dalin në pension dhe ne si Asamble e kemi marrë një vendim për kompensimin e tyre, mirëpo ky vendim nuk po zbatohet dhe ata duhet me ju drejtu gjykatave për këtë çështje, por përfaqësuesit e NISMA nuk rrinë këtu as për të diskutuar.


Ka pika tjera kërkesa të qytetarëve që kanë të bëjnë për ndërrim dhe destinim por nuk mund të merren vendimi për shkak të mungesës së asambleistëve të NISMA dhe AAK-së.

Ilaz Krasniqi: Është një kërkesë mër ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Unë kërkoj që çdo kërkesë e qytetarëve të kalojë përmes Zyrës Ligjore e të mos vien këtu sepse shpeshherë kur ka këso kërkesa nuk po kalojnë sepse NISMA nuk është këtu. Nëse merret diçka jashtëligjshëm le të jëni ju përgjegjës sepse qëllimi po dihet që veç t'ju hudhet faji Kuvendit e ekzekutivi të mbetet mirë me qytetarët.

Rrahim Morina: Falemnderit për pjesëmarrjen me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur në mungesë të kourrumit.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00.

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina

